



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 147

Ora: 10:25

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 85, DATË 24.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri

PALË E INTERESUAR: Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi

OBJEKT: 1. Kundërshtimin e vendimit nr. 539, datë 20.05.2023 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore bashkia Elbasan, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023".



2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore bashkia Elbasan.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 85 regj., datë 24.05.2023.

Në mbledhjen e datës 26.05.2023, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 85 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 85, datë 24.05.2023, të paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 01.06.2023, ora 12:30.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar